L I G J
Nr.9487, datë 6.3.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9047, DATË 10.7.2003 "PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Fjalia e dytë e pikës 1 të nenit 10 ndryshohet si më poshtë:
"Shtetasi shqiptar që ka përfunduar një shkollë të lartë universitare me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit, përjashtohet nga kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.".

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime e shtesa:
1. Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:
"b) për rastet e fatkeqësive familjare dhe kur personat në ngarkim të ushtarit mbeten pa përkujdesje;".
2. Pas shkronjës "c" shtohen shkronjat "ç" dhe "d" me këtë përmbajtje:
"ç) shtetasi kryefamiljar, i cili gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ushtarak bëhet me dy ose më shumë fëmijë;
d) titullohet ushtar profesionist.".
3. Në paragrafin e fundit shprehja "shkronjave "a", "b" dhe "c"" bëhet "shkronjave "a", "b", "c", "ç" dhe "d"".

Neni 3

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 36/1
Detyrimet e organeve të Policisë së Shtetit

Organet e Policisë së Shtetit në qarqe detyrohen të shoqërojnë për në qendrën e rekrutim-mobilizimit të qarkut shtetasit, të cilët janë thirrur për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas listëthirrjeve të dërguara nga qendra e rekrutim-mobilizimit dhe që nuk janë paraqitur në qendrën e rekrutim-mobilizimit.
Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Brendshëm nxjerrin udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij neni.".

Neni 4

Në pikën 3 të nenit 40, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Vendimi i komisionit është titull ekzekutiv.".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4815, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu